



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 1784/24 prot.

Pogradec, më 06.05 2026

VENDIM

Nr. 60, DATË 30/04 /2026

PËR

“MIRATIMIN E KALIMIT TË AKSIONEVE TË BASHKISË POGRADEC NGA SHOQËRIA “KRWM” SH.A TEK SHOQËRIA “AGJENCIA KOMBËTARE E EKONOMISË SË MBETJEVE” SH.A

Në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Ligjit nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, të nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1, nenit 23 pika 10, nenit 55 pikat 2 dhe 6, nenit 54 gërma k të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Ligjit Nr.57/2025 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, në VKM Nr. 37, datë 21.01.2026 “Për përcaktimin e organizimit të brëndshme të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve” sh.a si dhe referuar shkresës me Nr.44/2 Prot. Datë 30.03.2026, me lëndë “Njoftim për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pogradec nga shoqëria “KRWM”sh.a tek shoqëria “Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve” sh.a të paraqitur nga Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:



1. Të miratojë kalimin e aksioneve që Bashkia Pogradec zotëron në shoqërinë “KRWM” sh.a me NUIS: **K84227001O**, tek shoqëria “**Agjencia Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve**” sh.a.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike dhe administrative për zbatimin e këtij vendimi, përfshirë:
 - a) nënshkrimin e aktit të transferimit të aksioneve;
 - b) përfaqësimin e Bashkisë Pogradec në organet e shoqërisë “KRWM” sh.a;
 - c) dhënien e çdo autorizimi të nevojshëm për depozitimin dhe regjistrimin e ndryshimeve përkatëse.
3. Ngarkohet Përfaqësuesi i Bashkisë Pogradec në Asamblenë e Aksionarëve të shoqërisë “KRWM” sh.a., të përfaqësojë Bashkinë me të drejtë vote në cdo vendimmarrje që lidhet me zbatimin e transferimit të aksioneve sipas këtij vendimi dhe me pasqyrimin e tij në regjistrat publikë përkatës.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI



1. Miratuar me 20 vota

2. Vota Pro 20

3. Vota Kundër 4

4. Vota Abstenim 2

5. Zbardhur më date 30.04.2026